



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:055161
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06080973

C. nr. 884/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Atdhe Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqësojnë B.K. dhe F.G. që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e pagës bazë në bazë të kualifikimit, me vlerë të kontestit 1,107 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.B. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit shtesat për licencën-kualifikimin me diplomë fakultet 3 dhe 4 vjeçar ti bëhet kompensim shtesë për 27 %, nga paga bazë prej 421 euro, apo shumën e gradimit prej 113.67 euro ku aktualisht paguhet vetëm shuma prej 58.32 euro, përkatësisht 55.35 euro, në muaj më pak dhe atë nga data 01.05.2021 deri më datë 31.12.2022, për 20 muaj në shumë prej 55.35 euro dhe atë në shumë të përgjithshme të pa paguar 1,107 euro, e cila duhet të paguhet në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës,” e pa bazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarve të tij B.K. dhe F.G. që të dy avokat nga Prizreni, në këtë gjykatë ka paraqitur padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në padi ka theksuar se paditësi është mësimdhënëse pranë SHFMU “Mushnikova” në fshatin Mushnikovë Komuna e Prizrenit, paditësi është i kualifikuar me diplomë Universitare, të njëjtit që nga data 01.05.2021 e deri më 31.12.2022, DKA-ja, nuk ja ka paguar shtesat e licencimit. Tutje në padi ka theksuar se në bazë të listave të pagave mësimdhënësit këtu A. B. si paditës, nuk e merr në tërësi shumën totale sipas vlerësimit por më pak se gjysma e sajë, ndërsa shuma tjetër ka ngelur pa e paguar deri më tani.

Nga arsyet e paraqitura në padi, baza ligjore e theksuar, kanë kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që në emër të kompensimit të pagës shtesë për licencën-kualifikim për 27 %, nga paga bazë prej 421 euro, apo shumën e gradimit prej 113.67 euro ku aktualisht paguhet

vetëm shuma prej 58.32 euro, përkatësisht 55.35 euro, në muaj më pak dhe atë nga data 01.05.2021 deri më datë 31.12.2022, për 20 muaj në shumë prej 55.35 euro dhe atë në shumë të përgjithshme të pa paguar 1,107 euro, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 28.06.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi deri më datë 31.12.2022, janë të pa bazuara për arsye se në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023, datë 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet të trajtohen deri më datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi për kualifikim dhe licencim është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Padija është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të kompensimit të 19 %, 27% 35%, siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Nga të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj ti të pabazuar padinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e paditura në përgjigjen në padi rezulton qartazi se kërkesëpadija e paditëses është e pa bazuar.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi A.B. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës.

Gjykata përmes kontratës me numër të protokollit 65/17 të datës 25.09.2017, vërtetoi faktin se paditësi ka kualifikimin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe ka pagë mujore 405.00 euro.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitën ligjore 399 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, në mungesë të provave dhe fakteve, rezultoi se kërkesëpadija e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësi të kompensohet në bazë të kualifikimit me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet për 27 % të pagës bazë 421 euro, apo shumën e gradimit prej 113.67 euro, ku aktualisht paguhet vetëm shuma prej 58.32 euro, përkatësisht 55.35 euro në muaj më pakë, dhe atë nga data 01.05.2021 deri më datë 31.12.2022, apo për 20 muaj të cilat kur shumëzohen në shumë prej 55.35 euro del shuma e përgjithshme e pa paguar 1,107 euro.

Neni 99.3 i LPK-së përcakton “në qoftë se deklarata përmban ndonjë kërkesë, pala duhet në parashtrësë t’i tregoj faktet mbi të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat kur është nevoja për një gjë të këtillë” ndërsa neni 253.1 i LPK-së përcakton “padija duhet të përmbajë: b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën; c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla; dhe f) të dhënat e tjera që duhet t’i ketë çdo parashtrësë (neni 99 i këtij ligji)”, e që në rastin konkret paditësi në padinë e parashtruar pranë kësaj gjykate vetëm i ka përmendur provat përmes të cilave do të vërtetohej se paditësi në bazë të listës së pagave nuk e merrë në tërësi shumën totale sipas vlerësimit por më pak se gjysma e saj, ndërsa shuma tjetër ka ngelur pa paguar deri më tani, por paditësi nuk ia ka bashkangjitur padisë listën e pagës për ta vërtetuar një fakt të tillë, si rezultat i kësaj nuk ka arritur të provoj pretendimet e thëna në padi, andaj gjykata vendosi që të refuzohet kërkesëpadija në tërësi si e pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar ato.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 143 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.884/2024 datë 23.08.2024

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.